

VENDIM
Nr. 784, datë 15.12.2021

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 843, DATË 28.10.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR ‘RRUGA LIDHËSE E APOLONISË’”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 843, datë 28.10.2020, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:
 - a) Në pikën 3, shifra “... 3 620 740 (tre milionë e gjashtëqind e njëzet mijë e shtatëqind e dyzet) lekë ...” zëvendësohet me “... 4 089 068 (katër milionë e tetëdhjetë e nëntë mijë e gjashtëdhjetë e tetë) lekë ...”.
 - b) Pika 4 ndryshohet, si më poshtë vijon:
“4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 4 089 068 (katër milionë e tetëdhjetë e nëntë mijë e gjashtëdhjetë e tetë) lekësh, të përballohet nga fondet e miratuara për Autoritetin Rrugor Shqiptar.”.
 - c) Të dhënat për pasurinë me numër rendor 15, në tabelën bashkëlidhur vendimit, zëvendësohen me të dhënat e tabelës, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
 2. Shpenzimet procedurale, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga buxheti i miratuar për Autoritetin Rrugor Shqiptar.
 3. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencia Shtetërore për Shpronësimin, Autoriteti Rrugor Shqiptar, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Fier, si dhe Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës pranë Këshillit të Qarkut Fier për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Arben Ahmetaj

LISTA EMËRORE E PRONARIT PRONË PRIVATE, QË PREKET NGA DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË VENDIMIN NR. 843, DATË 28.10.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR ‘RRUGA LIDHËSE E APOLONISË’”

Në VKM-në nr. 843, datë 28.10.2020										Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM-në nr. 843, datë 28.10.2020										
Nr. rendor sipas VKM-së	Emër Atësi Mbiemër	ZK	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sip.	Sip. e shpronësuar/ m ²	Çmimi në lek/m ²	Vlera totale për shpronësim	Shënime	Nr. rendor sipas VKM-së	Emër Atësi Mbiemër	ZK	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sip.	Sip. e shpronësuar/ m ²	Çmimi në lek/m ²	Vlera totale për shpronësim	Shënime	
					Totale										Totale					
					/m ²										/m ²					
15	Vasil Lili Cuni	3015	100/1	Arc	4,929	216	269	58,105	Konfirmuar nga ASHK-ja	15	Vasil Lili Cuni	3015	100/24	Arc	5088	1957	269	526,433	Konfirmuar nga ASHK-ja	
Vlera totale					4,929.0	1,957		58,105		Vlera totale					5,088.0	1,957		526,433		
Vlera shtesë në lekë që kërkohet për shpronësim 468,328 lekë																				

Sbënime. 1. Për tokën “arc”, çmimi i llogaritur është marrë nga vendimi nr. 89, datë 3.2.2016, i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e bartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”.